

VENDIM
Nr. 876, datë 12.12.2012

PËR SHLYERJEN E NJË PJESE TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA NDAJ
“ALBTELECOM” SHA, PËR TARIFAT E SHËRBIMIT TELEFONIK FIKS PËR PERSONAT
ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10 të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të nenit 12 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar dhe të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nga fondet e vitit 2012 të programit të Mbrojtjes Sociale, artikulli 602 “Mallra e shërbime të tjera”, t’i paguajë “Albtelecom” sh.a., shumën prej 51 206 371 (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekësh.

2. Fondi prej 51 206 371 (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekësh të përdoret për shlyerjen e një pjese të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për tarifën telefonike dhe për pagesat e energjisë elektrike nga personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, “Albtelecom” sh.a.

3. Likuidimi i vlerës prej 51 206 371 (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekësh të kryhet mbi bazën e dokumentacionit justifikues, të paraqitur nga “Albtelecom” sh.a., dhe të miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha